

MËSIMI DHE MEMORIA

EKZISTOJNË DY FORMA TË MËSIMIT

1. Mësimi IMPLICIT
2. Mësimi EKSPILCIT

Përbërësit e Mësimit Janë

1. Përvoja
2. Instruksionet
3. Shpjegimet

MËSIMI

- mësimi implicit: i pavetëdijshëm, i lindur
- nuk kërkon instruksione
- bazohet në përvojë

- ndjek rrugën dorsale
- përdor sistemin e memories procedurale implicite

- mësimi eksplicit: vullnetar
- i referohet instruksioneve

- ndjek rrugën ventrale
- përdor sistemin e memories deklarative eksplicite

MËSIMI IMPLICIT

Mekanizmat e lindur të njohjes, akumulimit dhe kategorizimit regjistrojnë gjurmët e çdo përvoje, i akumulojnë gradualisht, i forcojnë nëse janë parë më parë, i klasifikojnë si të njohura ose të reja dhe më pas i kategorizojnë.

Neuroscienat e përcaktojnë këtë grup mekanizmash të lindur si: Aktivitet kompjuterik, mekanizëm që na lejon të mbajmë gjurmët e stimujve dhe të kërkojmë përmbajtje dhe ndryshime, duke krijuar kategori, të cilat janë pararendës të koncepteve.

MËSIMI EKSPILCIT

- Është vullnetar...dhe kërkon
- instruksione
- shpjegime
- Kjo formë mësimi, duke kërkuar një farë pjekurie të proceseve të kuptimit të gjuhës dhe memories, nuk ndodh para moshës 4 vjeçare.

- Edhe mësimi eksplicit kërkon përsëritje, ushtrim, mekanizmin e akumulimit.

- Dy format e mësimi, implicit dhe eksplicit, zakonisht bashkëveprojnë me njëra-tjetrën (përveç në rastet e subjekteve me çrregullime të gjuhës dhe të mësimi).

Nëse kjo ndërveprim nuk ndodh, mësimet eksplicite-shkollore mbeten vetëm memorizim i pastër dhe për këtë arsye janë të ekspozuar ndaj harresës.

SHKOLLA DHE MËSIMI EKSPILCIT

Shkolla punon shumë me mësimin eksplicit, bazuar në instruksionet.

Pse DSA-të nuk i mbajnë mend?

Sepse instruksionet funksionojnë nëse funksionon mirë sistemi i memories procedurale - Mësimi implicit.

Tek ata ky sistem është DEFICITAR

jo sepse nuk kanë memorien afatgjatë,

por sepse kanë vështirësi në lidhjen e fragmenteve.

MEMORIA KA NEVOJË, në vend të kësaj, PËR RRJETE INFORMACIONESH, JO PËR FRAGMENTE INFORMACIONESH.

MEMORIA

Aftësia e trurit për të ruajtur informacionin në periudha të shkurtra dhe të gjata kohore, që kërkon një proces të:

Kodifikimit

Ruajtjes / mbajtjes

Rikuperimit: njohje/rikujtim

STRUKTURA E MEMORIES NJERËZORE

Memoria njerëzore ka një natyrë polisemike, në kuptimin që përbëhet nga sisteme të ndryshme secili prej të cilëve aktivizon një seri rrjetesh cerebrale që kryejnë procese specifike mnemonike.

PRIMING. SISTEM MNEMONIK I PAVETËDIJSHËM QË LEJON NJË STIMUL, TË CILIT I ËSHTË EKSPOZUAR NJË HERË, TË NJIHET MË VONË PA PASUR VETËDIJEN E KESAJ NJOHJE.

MEMORIA PROCEDURALE IMPLICITE

Rruga dorsale mbikëqyr

memories implicite-procedurale me të cilën janë të lidhura:

lëvizja

përfaqësimi hapësinor

orientimi djathtas-majtas

kontrolli i syve dhe krahëve

sekuencialiteti

PROCEDURALE sepse përfshin forma të mësimit të pavetëdijshëm siç janë: shfaqja dhe zakonet

MEMORIA DEKLARATIVE

- Rruga ventrale mbikëqyr memories eksplicite-deklarative që rregullon:
- imazhet mendore
- Karakteristikat e formave
- Ngjyrat

DEKLARATIVE sepse përfshin njohuri që potencialisht mund të deklarohen, domethënë të rikujtohen mendërisht ose në formë imazhesh mendore.

MEMORIA AFATSHKURTËR

- Neuroscienat na thonë se është ajo pjesë e memories që besohet të jetë e aftë të ruajë një sasi të vogël informacioni, të quajtur "span e memories".
- Ruhet mesatarisht midis 5 dhe 9 elemente për një kohëzgjatje prej rreth 2 sekondash.
- Kapaciteti i magazinimit të memories afatshkurtër nuk është lehtësisht i modifikueshëm madje disa thonë që NUK ËSHTË I MODIFIKUESHËM.

MEMORIA E PUNËS

Është aftësia për të mbajtur në mendje dhe për të manipuluar informacionet (të përmbajtura në memorien afatshkurtër) për një periudhë të shkurtër kohore.

- mban dhe përpunon informacionet gjatë kryerjes së detyrave njohëse.
- Kushdo që ka probleme me memorien e punës nuk është në gjendje të menaxhojë për një kohë të gjatë vëmendjen sepse kalon në mbingarkesë njohëse.

memoria e punës është e përfshirë në:

- rikuperimin e informacionit nga memoria afatgjatë.
- organizimin e diskursit (kur duhet të gjejnë fjalët e duhura dhe t'i organizojnë ato në mënyrë efektive).
- rikuperimin leksikor.
- organizimin sintaktik.
- kuptimin e tekstit (lidhjet).
- arsyetimin matematik - aritmetik.

Mbingarkesa e memories së punës:

- ka tendencë të fshijë informacionet, jo t'i ruajë ato.
- ka tendencë të humbasë vëmendjen.
- Një kompromis në këtë fushë gjendet shumë shpesh.

- si tek njerëzit me çrregullime të vëmendjes,
- ashtu edhe tek njerëzit me DSA.

Vështirësi në:

- Mbajtjen e vëmendjes.
- Planifikimin e kohëve.
- Përfundimin e aktiviteteve.
- Kryerjen e detyrës në mënyrë të pavarur.
- Ndjekjen e instruksioneve.
- Kombinimin e ruajtjes dhe përpunimit.
- Monitorimin e aktivitetit (në cilën pikë jam?).
- Autokorrigjimin.
- Veprimin të vetëm.

PASOJAT:

- Humbja e vëmendjes.
- Mendimi i humbur (mendje e lëvizshme).
- Ndërveprimi i dobët në grup.
- Vështirësia në marrëdhëniet me bashkëmoshatarët.
- Dështimi në aktivitetet shkollore, për shkak të mbingarkesës së kërkesës së memories së punës në aktivitetet e mësimit të strukturuar.

PARIMET E NDËRHYRJES

- Njohja e joefikasitetit të memories së punës.
- Ndjekja më e afërt e fëmijëve.
- Peshimi i ngarkesave të memories.
- Reduktimi i ngarkesave të memories.
- Përsëritja e informacioneve të rëndësishme.
- Inkurajimi i përdorimit të mbështetjeve për memorien.
- Sugjerimi i strategjive për mbështetjen e memories te fëmija.

.

UDHEZIME PËR DSA-TË

- Kuptimi i çrregullimit dhe origjinës së tij.
- Përpjekja për të pasur pritshmëri të sakta në lidhje me potencialet e fëmijës.
- Sigurimi i qëllimeve të qarta dhe të personalizuara të mësimit.
- Përrjashtimi nga performancat që nuk janë relevante për fëmijën.
- Sigurimi i udhëzimeve me një aplikabilitet të vërtetë përtej kufijve të shkollës (familjariteti).
- Shfrytëzimi i njohurive dhe aftësive tashmë të zotëruara nga nxënësi me DSA dhe ta bëjë atë të vetëdijshëm.
- Stimulimi i bashkëpunimit dhe pjesëmarrjes.
- Dhënia e komenteve të sakta, të shpeshta dhe të përshtatshme.

Nga: Giacomo Stella, Universiteti i Modenas dhe Reggio Emilias